


KOMUNIKIMI I ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT ME PALËT E INTERESUARA

Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe
mbikqyrja parlamentare MK 18 IPA FI 03 20



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian



RRETH NESH



Enti Shtetëror i Revizionit

Sepse **TRANSPARENCA** dhe **KOMUNIKIMI** janë rruga jonë e përbashkët drejt **SUKSESIT!**

KUSH JEMI?

Enti Shtetëror i Revizionit është një institucion i pavarur suprem i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Është themeluar në vitin 1997, me miratimin e ligjit të parë për revizion shtetëror (G.Z 65/97).

MISIONI

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është institucioni suprem i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila synon të informojë me kohë Kuvendin, Qeverinë, zyrtarë të tjerë publik dhe publikun e gjerë për gjetjet e revizioneve të kryera.

ESHR e mbështet Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e kompetencave të tij duke identifikuar dhe paraqitur parregullsi, raste të veprimeve të paligjshme dhe raste të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës.

Nëpërmjet rekomandimeve të qarta dhe efektive, ESHR-ja ofron mbështetje për institucionet shtetërore dhe përdoruesit e fondeve publike për të përmirësuar qeverisjen dhe kështu kontribuon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VIZIONI

Me qëllim përmbushjen me sukses të qëllimit tonë – **PËRKUJDESJA E FONDEVE PUBLIKE DHE KONTRIBUIMI NË PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË TYRE**, vizioni ynë është të sigurojmë vazhdimisht cilësi në punën tonë, e cila do të ruajë epitetin e një partneri të pavarur dhe profesional me integritet të lartë i cili është në të njëjtën kohë bartës i progresit në menaxhimin e fondeve publike, llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e tyre.

Enti Shtetëror i Revizionit njihet si një institucion me vlera të larta që inkurajon dhe zhvillon vazhdimisht: aftësi profesionale, kryerje të përgjegjshme të detyrave të punës, punë në ekip, besueshmëri dhe profesionalizëm, etikë, si dhe integritet profesional dhe personal të revizorëve shtetërorë të çertifikuar.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Sigurimi i pavarësisë së plotë të ESHR-së
2. Zhvillimi i mëtejshëm i cilësisë së revizionit shtetëror
3. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit institucional të menaxhimit të kapaciteteve të ESHR-së
4. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të informacionit të ESHR-së dhe zbatimit të teknologjisë informatike
5. Përmirësimi i sistemit të komunikimit dhe shkëmbimit të informacioneve me persona juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

ME ÇFARË PUNËSH MERREMI?

Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizione të realizimit dhe përdorimit të fondeve publike nga njësitë e sektorit publik në nivelin qendror dhe vendor.

Për parregullsitë e identifikuara të biznesit, u jep rekomandime subjekteve me qëllim të menaxhimit më të përshtatshëm dhe më efikas të fondeve publike, të cilat në fund të fundit kontribuojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



RKSH do të jetë mysafir në emisionin „Magazina Ekonomike” (TV Alsat)

SI I KRYEJMË ATO PUNË?

Si një revizor i jashtëm i pavarur, ESHR kryen revizione në përputhje me standardet e revizionit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), duke aplikuar kualifikime të larta profesionale dhe arsimim të vazhdueshëm të punonjësve, e cila është një vlerë themelore në punën e institucioneve supreme të revizionit (ISR).

KOMUNIKIMI



Sepse **TRANSPARENCA** dhe **KOMUNIKIMI** janë rruga jonë e përbashkët drejt **SUKSESIT!**

CILA ËSHTË RËNDËSIA E PUBLIKIMIT TË PUNËS SONË DHE PËRFITIMET E KOMUNIKIMIT ME PALËT E INTERESUARA?

Transparenca dhe llogaridhënia është një nga qëllimet kryesore strategjike të çdo ISA, ndërsa rëndësia e komunikimit me palët e interesuara theksohet nga një numër organizatash dhe institucionesh relevante ndërkombëtare, përfshirë INTOSAI, EUROSAI, OECD / SIGMA, IDI, Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara.

Enti Shtetëror i Revizionit informon publikun për punën dhe aktivitetet e saj, si dhe për rezultatet dhe efektet e arritura nga revizionet e subjekteve të përfshira në programin vjetor të punës, në mënyrë transparente, në kohë dhe objektivist, mes tjerash, duke publikuar të dhëna që përmbahen në raportet përfundimtare të auditimit në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Revizionit (www.dzr.mk/sq).

Sinergjia që rezulton nga bashkëpunimi i mirë ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe palëve të saj të interesuara mund të arrijë përfitime të shumta:

- pozicionimi i Entit Shtetëror të Revizionit si një institucion profesional, i pavarur dhe relevant, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien dhe duke rritur besimin e publikut në punën e tij, si dhe duke forcuar kështu reputacionin e institucionit

- rrit informacionin, efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën e sektorit publik, forcimin e besimit të qytetarëve në institucione, rritjen e efikasitetit të palëve të interesuara dhe reputacionin e tyre në shoqëri, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe përdorimin më efikas të burimeve publike dhe rritjen e besimit të qytetarëve në demokraci dhe të drejtat e njeriut.

KUSH JANË AKTORËT TANË TË JASHTËM?



AUTORITETET PUBLIKE:



KUVENDI



QEVERIA DHE MINISTRIA E FINANCAVE



ZYRA E PROKURORIT PUBLIK



KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME



TË REVIDUARIT



ORGANIZATAT E REVIZIONIT TË
BRENDSHËM DHE ISR TË TJERA



SEKTORI QYTETAR DHE ORGANIZATAT
E SHOQËRISË QYTETARE



MEDIAT



OPINIONI I GJERË PUBLIK


SI KOMUNIKOJMË ME ATA?

Enti Shtetëror i Revizionit ka zhvilluar një Strategji të Komunikimit për vitet 2020 - 2023.

Kjo strategji moderne përqendrohet në opinionin e gjerë publik, si dhe krijimin dhe inkurajimin e komunikimit të dyanshëm dhe të hapur me palët e interesuara, e cila gjë arrihet në mënyra të ndryshme (faqja e internetit të ESHR-së, rrjetet sociale (Twitter, Facebook, YouTube), kanalet televizive, njoftimet, konferencat për shtyp, e-mail, punëtoritë dhe trajnimet, takimet, etj.)



CILAT JANË PARIMET THEMELORE TË KOMUNIKIMIT TONË?



Sepse **TRANSPARENCA** dhe **KOMUNIKIMI** janë rruga jonë e përbashkët drejt **SUKSESIT!**

CILA ËSHTË RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT TË MIRËFILLTË PËR AKTORËT?

- të jenë të informuar për punën e Entit Shtetëror i Revizionit
- të pranojnë informacione të sakta dhe me kohë për biznesin/veprimtarinë e të reviduarëve
- të rritet efikasiteti i palëve të interesuara (bazuar në informacionin mbi parregullsitë për biznesin/veprimtarinë e të reviduarëve që ata kryejnë detyra brenda kompetencave të tyre dhe marrin vendime afariste)
- Kontribut për rritjen e llogaridhënies në sektorin publik (bazuar në informacionin mbi parregullsitë për biznesin/veprimtarinë e të reviduarëve që ato ndikojnë në njësitë ekonomike për të vepruar sipas rekomandimeve të Entit Shtetëror të Revizionit)
- informacione mbi punën e institucioneve supreme të revizionit dhe biznesit/veprimtarisë së të reviduarëve është baza për studime dhe punime shkencore dhe profesionale.



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËR NE KOMUNIKIMI YNË I BRENDSHËM?

Një Institucion Suprem i Revizionit të suksesshëm përbëhet nga punonjës të mirëinformuar, që do të thotë se punonjësi ka informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat brenda kompetencave të tij/saj, por edhe shumë më tepër - që ai/ajo të jetë i/e informuar për aktivitetet dhe ngjarjet brenda institucionit.

Informacionet e kontaktit me ESHR

KONTAKTI PËR MEDIAT:

Albiona Mustafa Muhaxhiri

☎ +389 72 228 203 ✉ albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijalce Durgutov


☎ +389 70 358 486 ✉ mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak

☎ +389 75 268 517 ✉ martin.duvnjak@dzt.gov.mk



State Audit Office
Tkalčićeva 19
10 000 Zagreb
Croatia
+385 1 46 27 888
+385 1 48 13 296
revizija@revizija.hr



Bulgarian National Audit Office
37, Ekzarh Yosif Str.
1000 Sofia
+359 2 980 36 90
president@bulnao.government.bg



State Audit Office
Pavel Shatev St. 2
Palata Emanuel Chuchkov
1000 Skopje
Republic of North Macedonia
++389 2 32 11 520
++389 2 32 11 262
dzt@dzt.gov.mk



Heqje të përgjegjësishë: Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e projektit dhe asesi nuk mund të konsiderohet që i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

www.dzt.mk/sq